



Prizren 7.11.2016

i nderuar Shef i Zyrës së Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni z. Mantovanelli

I nderuar Kryetar i Komunës z. Muja

I nderuar Zëvendësministër z. Krasniqi

Të nderuar anëtar të Bordit të BQK-së

Të nderuar përfaqësues të mediave

Të nderuar zonja dhe zotërinj

Kam kënaqësinë e veçantë që t'ju dëshiroj mirëseardhje në Inaugurimin e Qendrës së Bankës Qendrore për Vazhdimësinë e Punës. Inaugurimi i Qendrës së sotme shënon hapin e fundit të implementimit të plotë dhe të suksesshëm të projektit ***Fuqizimi i Sektorit Financiare dhe infrastrukturës së tregut***, të financuar nga kredia e Bankës Botërore në vlerë prej 6 milionë dollar dhe përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Financave. Projekti ka qenë gjithashtu i shoqëruar me grant në vlerë prej 2 milionë dollarësh në formë të asistencës teknike.

Fillimisht, më lejoni të falënderoj z. Mantovanelli dhe ekipin e tij për mbështetjen e vazhdueshme për të tejkaluar sfidat me të cilat është ballafaquar procesi i implementimit dhe duke i shndërruar ato në rezultate konkrete. Dëshiroj, gjithashtu të falënderoj Ministrinë e Financave për përkrahjen e parzervë në lehtësimin e zbatimit të projektit, pastaj Komunën e Prizrenit për mundësinë e ofruar, që qendrën e vazhdimësisë së punës ta funksionalizojmë në objektin me standardet më të mira ndërkombëtare në qytetin e Prizrenit. Gjithashtu vlen të theksoj edhe përkushtimin maksimal të ekipit të gjerë të Bankës Qendrore për jetësimin e plotë të këtij projekti të cilëve u jam mirënjohës.

Objektivi parësor i BQK-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Paralelisht, projekti ***Fuqizimi i Sektorit Financiare dhe infrastrukturës së tregut*** ka qenë në funksion të avancimit të mëtutjeshëm të këtij objektivi duke përkrahur stabilitetin dhe zhvillimin e sektorit financiar, si dhe avancimin e infrastrukturës së këtij sektori. Rrjedhimisht, ndërtimi i Qendrës së Vazhdimësisë së Punës ka qenë njëra prej katër shtyllave të përfunduara suksesshëm dhe në funksion të avancimit të reformave në sektorin financiar. Në vijim më lejoni që shkurtimisht t'i përmendi në pika të shkurtra:

- a) **Avancimin e kornizës ligjore** dhe përfarimin e saj me direktivat evropiane dhe standardet ndërkombëtare, si dhe përmes asistencës teknike ngritjen e kapaciteteve të brendshme për mbikëqyrje të sektorit financiar në Kosovë (1.5 milion-grant).
- b) **Krijimi i platformës softuerike të bazuar në faqen zyrtare** për raportim financiar dhe rregullativ të të gjitha institucioneve financiare duke i mundësuar BQK-së, avancimin e mbiqyrjes efektive të sektorit financiar dhe duke ua lehtësuar institucioneve financiare ngarkesat e raportimeve të dyfishta. Nga qershori i këtij viti të gjitha institucionet financiare raportojnë të dhënat e tyre me platformën e re (vlera 500 mijë dollar-grant)
- c) Financimin i kostos që ndërlidhet me krijimin e sistemit për **Barazim të Pagesave në Kohe Reale është** projekt, i cili ka filluar të implementohet në korrik të këtij viti dhe është realizuar sipas standardeve më të reja ndërkombëtare, teknologjisë më bashkëkohore, si dhe praktikave më të mira në botë. Ky projekt e bën Kosovën të shquhet edhe në aspektin ndërkombëtar me një sistem bashkëkohor të pagesave që redukton kostot operative për bankat, rrit shpejtësinë, minimizon rrezikun e pagesës dhe rrit besimin në sektorin bankar. (Vlera 1.6 milion dollar)
- d) Financimi i kapitalit fillestar për **Fondin për Sigurim të Depozitave të Kosovës (DIFK)** nga Qeveria e Republikës së Kosovës e pranuar në formë të kredisë është realizuar suksesshëm në kuadër të këtij projekti. (Vlera 3.4 milionë dollar)

Shtylla e fundit e projektit- **Qendra vazhdimësinë së Punës** është ndërtuar me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së punës kur ndodhin rastet e ndërprerjeve të operacioneve, si rezultat i fatkeqësive (nga faktorë të pakontrollueshëm). Funkzioni kryesor i kësaj qendreje është rimëkëmbja e operacioneve të teknologjisë informative duke siguruar funksionimin e të gjitha sistemeve kritike të BQK-së në formë të “planit rezerve” me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të sektorit financiar. BQK-ja ka të institucionalizuar Strategjinë e Vazhdimësisë së Punës, si dhe ka themeluar organet relevante për implementimin e kësaj strategjie. Nga sot do ketë edhe objektin e funksionalizuar me teknologjinë dhe standardet bashkëkohore. Më duhet gjithashtu të theksoj se ky objekt do jetë destinimi i **Qendrës së trajnimeve dhe Edukimit Financiar** për t’i ofruar mundësi ngritjes profesionale jo vetëm për Kosovën por edhe regjionin. (Vlera e 1 milion dollar)

Në fund me lejoni të theksoj se përfitimet e BQK-së, sektorit financiar, sistemit të pagesave dhe Fondit për Sigurimin e Depozitave, nga ky projekt kanë ndikuar në avancimin kritik të të gjitha shtyllave të lartpërmendura dhe në të njëjtën kohë edhe përafrimit të sistemit financiar të Kosovës me standardet evropiane dhe ato ndërkombëtare.

Projekti **Fuqizimi i Sektorit Financiar dhe Infrastrukturës së Tregut** ka qenë një projekt kompleks, por të arriturat që u shpalosen sot janë treguesi më i mirë se si realizohen projekte të suksesshme kur ndërthuren zotimet dhe përkushtimi i përbashkët i institucioneve të Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare zhvillimore, në rastin tonë Bankën Botërore.

Duke ju falënderuar për pjesëmarrjen dhe vëmendjen tuaj, ftoj z. Mantovanelli për një fjalë rasti të përcjellë pastaj me vizitën në Qendrën të cilën e inauguroam sot.

Ju faleminderit!

